VENDIM
Nr.389, datë 7.9.1998

PËR MIRATIMIN E PROGRAMIT TË QEVERISË "PËR PLOTËSIMIN E NEVOJAVE TË REFUGJATËVE NGA KOSOVA" DHE PËR KRIJIMIN E KOMISIONIT PARLAMENTAR AD-HOC PËR MBIKËQYRJEN E ZBATIMIT TË KËTIJ PROGRAMI

Në mbështetje të neneve 30 dhe 89 të Rregullores së Kuvendit Popullor,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Miratimin e Programit të Qeverisë "Për plotësimin e nevojave të refugjatëve nga Kosova", i cili i është bashkëngjitur këtij vendimi.

II. Krijimin e komisionit parlamentar ad-hoc të përbërë nga 11 anëtarë për mbikëqyrjen e zbatimit të programit të parashikuar në pikën I të këtij vendimi.

III. Komisioni parlamentar do të mbikëqyrë dhe do të bashkëpunojë me institucionet shtetërore dhe të tjera të interesuara, të ngarkuara për zbatimin e masave të parashikuara në program.

IV. Komisioni do të informojë Kuvendin, në seancë plenare, një herë në çdo dy javë lidhur me zbatimin e masave të parashikuara në program, si dhe për probleme të veçanta që mund të lindin gjatë zbatimit.

V. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.